



Prishtinë: 27.10.2021
Kodi i ZRRE-së: V_1446_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2235_09_21** të dt. 14.09.2021;
- Ankesën e konsumatorit të dt. 01.10.2021;

në seancën e mbajtur më datë 27.10.2021 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa e konsumatorit F.S nga Komuna e Prishtinës.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2235_09_21, i datës 14.09.2021.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve në ZRrE me datë 14.09.2021 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2235_09_21, me të cilin e ka refuzuar ankesën e konsumatorit F.S nga Komuna e Prishtinës, lidhur me kontestimin e faturës së energjisë elektrike të dt.01.08.2019.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori F.S, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRrE-së për këto shkaqe:

- Në faturë nuk mund të kuptohet borxhi, dhe nuk është e qartë se si është llogaritur ky borxh në vlerë prej 5862.82 EUR;
- Konsumatorit nuk i është dhënë mundësia që të deklarohet pranë palës së kundërt dhe i njëjti pretendon se si rrjedhojë, vendimi atakuar është i kundërligjshëm;
- Konsumatori F.S kërkon nga Bordi i ZRRE-së që të anulohet vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_2235_09_21 i datës 14.09.2021.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 27.10.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin e konsumatorit se borxhi nuk mund të kuptohet dhe se është e qartë se si është llogaritur ky borxh, Bordi i ZRrE-së thekson se, pasi që ka administruar të gjitha provat dhe i ka analizuar secilën prej tyre vec e vec, ka konstatuar se, sipas Procesverbalit të dt. 06.07.2019 dhe fotot e bashkëngjitura nga vendi i ngjarjes, punëtorët e autorizuar të KEDS-it pas inspektimit të pikës matëse,



ndër të tjera, kanë evidentuar se “Me rastin e kontrollës tek konsumatori është gjetur njehsori elektrik nr. 20016382, i pa regjistruar në CCP, me gjendje të shpenzimeve TL=063348 kWh dhe TU=038573 kWh. Po ashtu, ekipi i KEDS ka evidentuar se në momentin e inspektimit, njehsori është pa harxhim dhe pa ngarkesë, si dhe që, njehsori elektrik është gjetur lartë në objekt nën kulm, si dhe dyshohet se ka pasur disa pajisje elektrike siç edhe mund të shihet nga fotot dhe njehsori i larguar nga matja merret për verifikim”. KEDS-i po ashtu ka ofruar edhe fotografitë si dëshmi, me të cilat vërtetohet gjendja e njehsorit të dytë, si dhe mund të provohet fakti që disa pajisje kanë qenë nën kulm. Në këtë procesverbal është evidentuar po ashtu se, konsumatori e kundërshton nënshkrimin e tij dhe se i lihet një kopje.

Bordi gjithashtu ka analizuar edhe Rrjedhën e Përgjithshme të energjisë elektrike si dhe listat leximit dhe konstaton se, lexuesi i KEDS-it ka bërë lexim dhe inspektim të rregullt mujor, dhe se vetëm në disa periudha ka evidentuar që nuk ka qasje në leximin e njehsorit, por që në asnjë rast nuk është evidentuar çfarëdo çrregullimi në furnizimin e konsumatorit. Pas krahasimit të shpenzimeve të energjisë me dy njehsorët elektrik, njehsorin nr.62275718 dhe nr. 32595689 për periudha të njëjta kohore. Bazuar në shpenzimet mujore të regjistruara në CCP, vërtetohet se: mesatarja mujore e shpenzimeve me njehsorin elektrik nr. 62275718 për periudhën 08/2016 deri në periudhën 08/2018 është **382 kWh/muaj** kurse me njehsorin nr. 32595689 mesatarja e shpenzimeve mujore për periudhën 08/2019 deri në periudhën 08/2021 është **1,070 kWh/muaj** e që kjo paraqet një rritje të shpenzimit prej **180%** me njehsorin e ri nr. 32595689.

Pra, pretendimi i konsumatorit se borxhi nuk mund të kuptohet dhe mbetet e paqartë se si është llogaritur, nuk mund të merret si i mirëqenë, pasi që si i tillë nuk qëndron, sepse konsumatori ka dështuar që të sqarojë se përse e ka poseduar një njehsor ilegal, i cili ka qenë i kyçur në rrjet, konsumatori është furnizuar me energji elektrike dhe se ky njehsor nuk ka qenë i lajmëruar. Po ashtu, konsumatori dështon të provojë se si janë regjistruar kilovatët në njehsorin e dytë nr. 20016382 (njehsori nën kulm). Lidhur me këtë çështje, siç edhe është sqaruar në vendimin kontestues, mbetet e paqartë se përse nuk është evidentuar nga ekipet e KEDS-it ky njehsor si njehsor ilegal dhe përse nuk janë marrë të gjitha masat për shkyçje. Por që, një lëshim i tillë i ndërmarrjes KEDS nuk e amnistion konsumatorin nga obligimi i tij ligjor që të paguajë për energjinë elektrike të konsumuar dhe të regjistruar në dy njehsorë elektrikë.

Po ashtu, Bordi ka gjetur se, dy procesverbalet mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit nr. 0826672 dhe nr. 0826673 datë 06.07.2019, është evidentuar se njehsori elektrik i pa regjistruar me nr. 20016382 është i vitit të prodhimit 2018 me çka edhe vërtetohet se shpenzimi prej **101,921 kWh** ka qenë e pa mundur të ndodhë për periudhë një mujore. Andaj, Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve me të drejtë ka konstatuar se, duke pasur parasysh shpenzimet e konsumatorit me vendosjen për matje të njehsorit elektrik nr. 32595689, vitin e prodhimit të njehsorit nr. 20016382 i cili është 2018, ka bërë shpërndarjen e kWh të faturuar në faturën 0719251089DPR-35724 datë 01.08.2019 për periudhën 01/2018 deri në periudhën 07/2019 dhe ka konstatuar se konsumatorit nuk i takon korrigjim financiar.

Në pretendimin e dytë të konsumatorit se nuk i është dhënë mundësia që të deklarohet dhe se si rrjedhë vendimi është i kundërligjshëm, Bordi thekson se, KEDS/KESCO me faktin se mos kthimit të përgjigjes konsumatorit në ankesën e tij, ka vepruar në kundërshtim me nenin 10 par. 1 të Rregullës



për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, mirëpo, vendimi i kontestuar, në asnjë formë nuk mund të konsiderohet i kundërligjshëm, pasi që në procedurë sipas ankesës në Zyrën e Rregullatorit për Energji, Bordi i ka vlerësuar të gjitha provat materiale, si procesverbalet, faturën, fotografitë, ankesat e konsumatorit të paraqitura në ZRrE, rrjedhën e energjisë elektrike e të ngjashme. Pra, përsëri nuk është kontestues fakti që ndërmarrja KEDS/KESCO ka vepruar në kundërshtim me Rregullën në fjalë, por që, konsumatorit i është dhënë mundësia që edhe në shkallë të parë edhe në shkallë të dytë në ZRrE, e në harmoni me legjislacionin në fuqi, t'i paraqes të gjitha kundërshtimet dhe provat tjera materiale. Kësisoj, konsumatori ka dështuar të provojë se vendimi i kontestuar – vendimi i DMK-së është i kundërligjshëm.

Duke u bazuar në nenin 5, par. 1.5 i Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, *“Të gjithë konsumatorët janë të obliguar që të paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për furnizim me energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifën për shfrytëzim të sistemit të miratuar nga ZRRE-ja”*. Ndërkaq në nenin 32 të kësaj rregulle, parashihet si në vijim: *“Konsumatori do të konsiderohet se shfrytëzon energji në mënyrë të pa kontraktuar nëse: 1.1. shfrytëzon energji në një mënyrë ose në sasi që nuk është si ajo që i është miratuar nga ndërmarrja e energjisë; 1.2. transmeton energji pas pikës matëse, në një vend tjetër, pa lejen e ndërmarrjes së energjisë, dhe ia përçon një shfrytëzuesi tjetër në një vend të ndryshëm nga vendi i kycjes në rretë; 1.3. nuk nënshkruan kontratën me furnizuesin e energjisë brenda afatit të dhënë dhe vazhdon të shfrytëzojë energjinë pa kontratë”*, Bordi ka konstatuar se ankesa e konsumatorit duhet të refuzohet.

Andaj, në harmoni me nenin 48 të Ligjit nr.05/L-031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative, Bordi i ZRrE-së i ka vlerësuar të gjitha pretendimet e ankuesit dhe i ka analizuar të gjitha dëshmitë dhe provat që lidhen më rastin në fjalë dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 27.10.2021 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-së,
- Konsumatorit F.S dhe
- Arkivit të ZRRE-së.